



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË

Nr. 653 Prot.

Tiranë, më 12 / 11 / 2013

Lënda: Dërgohet Rekomandim për Sjelljen në Vëmendje të Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

Drejtuar : Drejtoria Arsimore Rajonale, Lezhë

LEZHË

Për dijeni: znj. Lindita Nikolla
Ministër
Ministria e Arsimit dhe Sportit

TIRANË

Në kuadër të projektit me titull “*Për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të diskriminuar*”, të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) në partneritet me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur financiarisht nga Zyra e Kooperacionit Zviceran në Tiranë, po zhvillohen Ditë të Hapura, që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit për Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi” si dhe njohjen me problematikat që shqetësojnë komunitetin.

Gjatë këtyre takimeve të zhvilluara në Bashkinë e Lezhës jemi njohur me kërkesën e disa të rinjve mbi moshën 18-vjeç për të përfunduar arsimin bazë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përmbushje të qëllimit të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin dhe bazuar në kompetencën që i jepet në bazë të shkronjës “F”, të pikës 1, të nenit 32, të këtij ligji, për të bërë rekomandime për çfarëdo lloj çështje që lidhet me diskriminimin parashtron:



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Komisioneri ka ndjekur në vazhdimësi situatën në sistemin arsimor parauniversitar, si një nga fushat që ligji nr. 10 221, datë 04.02.2013 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” trajton në mënyrë të posaçme. Gjatë veprimtarisë së institucionit i KMD ka evidentuar se grupe dhe kategori nxënësish, si ata romë dhe egjiptianë, LGBT, me aftësi të kufizuara, apo ata nxënës që për shkak të kushteve të vështira ekonomike apo vendbanimit, përballen me vështirësi, deri në pamundësi për t’u arsimuar.

Në bazë të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, kategorive të veçanta të nxënësve u sigurohet kujdes i posaçëm nga shteti. Në bazë dhe për zbatim të këtij ligji, Ministria e Arsimit dhe Sporteve ka nxjerrë një sërë aktesh nënligjore zbatimi i të cilave së bashku me aktet, masat dhe planet e veprimit që janë në fuqi në mënyrë efektive është i domosdoshëm për të parandaluar dhe luftuar diskriminimin në fushën e arsimit.

Në udhëzimin nr.29, dt.02.08.2013, parashikohet dhe dhënia e shansit të dytë sipas të cilit: “*Fëmijët e moshës së detyrimit shkollor që kanë braktisur shkollën, e ndërpresin ose nuk e kanë ndjekur dhe nuk kthehen në shkollën bazë me kohë të plotë dhe as nuk ndjekin shkollën bazë me kohë të pjesshme, kanë të drejtë të ndjekin shkollimin e quajtur "shansi i dytë". Në vazhdim theksohet se : “ Nxënësi ka të drejtë të ndjekë "shansin e dytë" deri në moshën shtatëmbëdhjetë vjeç. Nxënësi, që ka mbushur moshën shtatëmbëdhjetë vjeç dhe nuk ka përfunduar "shansin e dytë", lejohet të përfundojë klasën që po ndjek”. Udhëzimi nr. 29, datë 02.08.2013“për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme” përcakton se: “Nxënësit që kanë mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe nuk e kanë përfunduar arsimin bazë me kohë të plotë, kanë të drejtë të regjistrohen në shkollat e arsimit bazë me kohë të pjesshme”.*

Duke patur parasysh situatën në cilën gjenden grupe të caktuara të rinjsh, gjëndjen e tyre ekonomike dhe për të garantuar në baza të barabarta me të tjerët të drejtën e tyre për arsimim, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:**

REKOMANDON

1. Zbatimin me efikasitet nga ana e Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë të udhëzimit e Ministrisë të Arsimit Nr. 29, datë 2.8.2013 “Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme”. Moszbatimi i këtyre udhëzimeve dhe mos dhënia e një mundësie tjetër këtyre të rinjve sjell në mënyrë të drejtëpërdrejtë përjashtimin e të rinjve rom nga e drejta për t’u arsimuar.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

2. Drejtoria Arsimore Rajonale në përmbushje të detyrimeve që dalin nga ligji “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet e dala Ministria Arsimit dhe Sportit, duhet të zbatojnë dhe monitorojnë të gjitha masat e përcaktuara për sigurimin që të gjithë fëmijët dhe të rinjtë të ndjekin arsimin e detyruar 9-vjeçar.
3. Drejtoritë Arsimore Rajonale në zbatim të detyrimeve që dalin nga Plani Kombëtar i Veprimit të Dekadës së Përfshirjes Rome, 2010-2015, duhet të zbatojnë dhe monitorojnë të gjitha masat e përcaktuara për të evidentuar numrin e fëmijëve romë, të cilët kanë braktisur shkollën, në të gjitha nivelet e sistemit arsimor parauniversitar.
4. Krijimi dhe/ose përmirësimi i të dhënave statistikore në fushën e arsimit që të mundësojnë analizat e vazhdueshme rreth gjendjes arsimore të fëmijëve Rom.
5. Ofrimi i këshillimit prindëror në shkolla dhe kopshte për prindërit Rom rreth të drejtave dhe detyrimeve për zhvillimin arsimor të fëmijëve.
6. Drejtoritë Arsimore Rajonale duhet të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme masat që marrin drejtuesit e institucioneve arsimore për të parandaluar dhe luftuar diskriminimin në shkolla.
7. Zbatimi i detyrimeve ligjore për marrjen e masave që synojnë përsheptimin e vendosjes reale të barazisë janë të domosdoshme për të luftuar dhe eliminuar diskriminimin në të drejtën për arsim të personave, dhe dështimi për të zbatuar me efektivitet këto masa mund të çojë në diskriminimin e grupeve të caktuara, të cilët gjenden në rrethana dhe kushte të ndryshme nga pjesa tjetër e shoqërisë.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

Koncept. Anuarola Gaku.




Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
 (Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
 Tel: +355 4 2431078
 Fax: +355 4 2431077
 e-mail: info@kmd.al
 web: www.kmd.al